



<b>Shpjeguesit e treguesve në rastet e fëmijës</b>		
	<b>Treguesit</b>	<b>Shpjegimet</b>
1.	Vijimi	Detajet e prezences së fundit të fëmijës në shkollë – Sa orë mësimi ka munguar fëmija
2.	Performanca akademike	Fëmija ballafaqohet me vështirësi në shkrim-lexim (të numrave dhe shkronjave) ka nota të ulëta dhe performancë të ulët akademike në lëndë të caktuara
3.	Sjellja	Nxënësi vazhdimisht sillet keq ose vazhdimisht është shumë agresiv në shkollë
4.	Mosha	Nxënësi është së paku dy vjet më i vjetër se moshatarët
5.	Shëndeti dhe paaftësia	Fëmija ka kufizime në aftësi ose sëmundje kronike afatgjate/Paaftësi (nevoja të veqanta), sëmundje kronike, shëndet mendor dhe fizik.
6.	Rrethanat familjare	Nxënësi është bonjak ose nuk jeton me prindër; prindërit e nxënësit janë me aftësi të kufizuara ose sëmundje mentale familja e nxënësit përballet me varfëri të skajshme ose ndonjë rrethanë tjetër ekstreme, nxënësi është i martuar ose është prind, fëmija punon.
7.	Përfshirja e familjes	Familja e nxënësit nuk e çmon arsimin; refuzon të angazhohet në shkollë ose angazhohet shumë pak në shkollë
8.	Presioni i bashkëmoshatarëve	Vllëzërit/motrat/kushërinjtë/ prindërit e nxënësit e kanë braktisur shkollën ose nuk kanë shkuar rregullisht në shkollë ose rrjeti kryesor i moshatarëve të nxënësit përfshinë fëmijë ose të rinj jashtë shkolle (të rinj më në moshë, braktisës) ose njerëz të njohur me sjellje anti-shoqërore
9.	Siguria	Fëmija është i rrezikuar nga dhuna familjare, abuzimi, neglizhenca ose dëmtimi.